



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT KRYETARI

Nr. 1114/48 Prot.

Tiranë, më 31.12.2016

V E N D I M

Nr. 194, Datë 31.12.2016

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË 13 SUBJEKTET E ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME”

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2015 dhe 2016, sipas programit të auditimit nr. 1114, datë 04.11.2016 si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, rezultoi se në **13** subjekte të audituara, janë rekomanduar gjithsej **405** masa, nga të cilat janë pranuar **398** masa ose **98%** e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar **7** masa ose **2%**. Konstatuam se nga **398** masat e rekomanduara dhe të pranura janë zbatuar plotësisht **222** prej tyre ose **55%**, pjesërisht **23** masa ose **5.7%**, dhe konsiderohen në proces zbatimi **139** masa ose **34.3%**. Nga auditimi rezultuan **21** masa të pazbatuara të cilat përfaqësojnë **5 %** të masave të propozuara.

Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

- 1. Masa organizative** janë rekomanduar 128 nga të cilat janë pranuar 128 masa ose 100 %. Nga masat e pranura, janë zbatuar 59 rekomandime, zbatuar pjesërisht 12 rekomandime, janë në proces zbatimi 53 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 4 rekomandime.
- 2. Masa shpërbllim dëmi** janë rekomanduar **85**, për vlerën **3,239,691 mijë lekë**, nga të cilat janë pranuar 78 masa me vlerë 2,698,744 mijë lekë, nga të cilat janë zbatuar plotësisht **21** rekomandime në vlerën 292,726 mijë lekë, janë zbatuar pjesërisht 11

masa në vlerën 35,788 mijë lekë, janë në proces zbatimi 43 rekomandime në vlerën 2,294,375 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 10 masa, në vlerën 654,590 mijë lekë.

3. **Masa administrative** janë rekomanduar **37**, nga të cilat janë pranuar **37** masa. Nga masat administrative të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **14** masa, janë në proces zbatimi **16** masa dhe janë pa zbatuar **7** masa.
4. **Masa disiplinore** janë rekomanduar **155**, nga të cilat janë pranuar **155** masa. Nga masat disiplinore të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **128** masa, dhe janë në proces zbatimi **27** masa.

Në kundërshtim me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, disa subjekte nuk kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara. Konstatohen subjekte që nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Për shkak të rasteve refuzuese të konstatuara në subjekte, por edhe të neglizhencës së treguar sidomos në ndjekjen e rekomandimeve me ndikim financiar, si dhe në funksion të luftës ndaj papërgjegjshmërisë së nëpunësve në realizimin e misionit të tyre si shërbyes të publikut, KLSH kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bashkëpunimin për ndjekjen e mëtejshme të zbatimit të rekomandimeve të KLSH^{së}, kryesisht në institucionet të cilat nuk kanë pranuar të nxjerrin urdhrat ekzekutive për zbatimin dhe plotësimin e rekomandimeve tona.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm*”, të ushtruar në 13 subjektet të audituara në tremujorin e katërt të vitit 2015 dhe 9 mujorin e vitit 2016.

II. TË RIKËRKOJË marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

1. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2015, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, përcjellë me shkresën nr. 545/46, datë 26.09.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm me shkresë nr. 22774/2, datë 03.10.2016, ka kërkuar që nga çdo departament, drejtori dhe degë doganore të zbatohen rekomandimet e KLSH-së. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sipas urdhrin të brendshëm nr. 22774/2, datë 03.10.2016 është miratuar Plani i Veprimit në lidhje me rekomandimet e KLSH-së sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku janë përcaktuar detyrat dhe afatet sipas sektorëve përkatës, i cili i është dërguar për informim edhe në KLSH.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, *nuk* ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, pasi nuk është plotësuar afati 6/mujor i dhënies së rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes 32 masa organizative, janë pranuar 32 masa nga të cilat janë zbatuar plotësisht 12 masa dhe janë në proces zbatimit 20 masa.
- b. 4 rekomandime për shpërblimin e dëmit në shumën 91,274,257 lekë, nga të cilat janë në proces zbatimi 4 masa.
- c. Për masa disiplinore janë rekomanduar 21 masa disiplinore, janë pranuar plotësisht 21 masa, të cilat janë zbatuar plotësisht 21 masa.

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave *i kërkojmë* përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën 545/46, datë 26.09.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe konkretisht, vlerësimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm, ka rezultuar se nuk janë zbatuar disa kërkesa të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” e rekomandohet që titullari i institucionit, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme, për hartimin e Strategjisë së riskut, mbledhjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik të paktën 4 herë në vit, kryerjen e rolit të koordinatorit të riskut apo delegimin e tij një nëpunësi tjetër të nivelit të lartë drejtues, me qëllim funksionimin sa më të mirë të pesë komponentëve të kontrollit të

brendshëm, duke ndikuar ndjeshëm në mirë menaxhimin e fondeve publike dhe rritjen e transparencës.

Menjëherë

2. Nga auditimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe konkretisht, vlerësimin të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm, si dhe nga auditimi mbi funksionimin e disa departamenteve dhe drejtorive operacionale gjatë vitit 2015, ka rezultuar se nuk janë zbatuar disa kërkesa të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është rekomanduar që Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e urdhrit për hartimin e hartave të proceseve të punës, si dhe përcaktimit të gjurmës së auditimit referuar përkatësisht shtojcës 3 dhe shtojcës 5 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të gjitha funksionet dhe proceset kryesore të të gjitha strukturave në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim lënien e gjurmës për çdo transaksion të kryer nga çdo punonjës.

Menjëherë

3. Departamenti Operativ-Hetimor dhe Departamenti i Akcizës, gjithë strukturat kontrolluese dhe konstatuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Degët Doganore Kompetente, gjatë hartimit të akteve të konstatimit, nxjerrjes së vendimeve doganore për kontabilizimin e detyrimeve të akcizës, të njoftojnë në mënyrë të detyrueshme Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi vlerën dhe sasinë e mallit të akcizës të gjetur në mungesë dhe të evidentojnë dhe detyrimet mbi TVSH-në, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar” dhe të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, për mallin e akcizës të gjetur në mungesë në Magazinë Fiskale të Depozituesve të Miratuar. Gjithashtu, rastet e mësipërme Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duhet t’ia përcjellë për shqyrtim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Menjëherë

4. Departamenti Operativ-Hetimor, gjithë strukturat kontrolluese dhe konstatuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave si dhe Degët Doganore Kompetente, gjatë hartimit të akteve të konstatimit të shkeljeve doganore kontrabandë, nxjerrjes së vendimeve administrative doganore për kontabilizimin e detyrimeve doganore të shmangura të marrin në konsideratë të plotë përcaktimin e nenit 281 pika 1,a, 291 dhe 283 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimin nr. 4 datë 30.09.1999, “Mbi Zbatimin e Dispozitave të parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor” në lidhje me kërkimin e sekuestrimit të mallrave që kanë shërbyer si objekt kontrabandë, në rastet kur kontrabanda rezulton e kryer e përfunduar, duke përdorur të gjithë mënyrat ligjore për kërkimin dhe sekuestrimin e këtyre mallrave objekt kontrabandë.

Menjëherë

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave të saj të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në profil risku të artikullit “aromatizues frutash” i deklaruar në kreun “3302”, me qëllim mostrimin laboratorik dhe ndjekjen e procedurave doganore verifikuese të plota për saktësimin e plotë të destinacionit të përdorimit të këtij artikulli “të një lloji të përdorur në industrinë e pijeve” të klasifikuara në kodin tarifor “33021040” me tarifë doganore 6%, apo “të një lloji të përdorur në industrinë e ushqimore” të klasifikuar në kodin tarifor “33021090” me tarifë doganore 2%.

Menjëherë

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Teknik dhe Drejtoria e Vlerësimit Doganor, të marrin masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje, apo udhëzimi mbi mënyrën e procedimit dhe kriteret e vlerësimit doganor. Në rregullore, apo udhëzim të përcaktohen:

- a. burimet e indicies ku Drejtoria e Vlerësimit Doganor mbështetet për fillimin e një përditësimi të “dosjes së të dhënave të disponueshme”;
- b. afati në dispozicion të Sektorit të Vlerësimit Doganor, që prej kërkesës për kryerjen e përditësimit të “dosjes së të dhënave disponueshme”, deri në propozimin për ndryshim;
- c. burimet e informacionit, të dhënat, analizat statistikore, historikun e artikujve, mbi të cilat Sektori i Vlerësimit Doganor, mbështetet për argumentimin dhe vendimin për propozim të përditësimit të “dosjes së të dhënave të disponueshme”;
- d. të përcaktojë formatin e aktit të vlerësimit dhe të propozimit për përditësim të “dosjes së të dhënave të disponueshme”, ku të përshkruajë indicien apo kërkesën për fillimin e procedurës, informacionin e mbledhur apo analizat e kryera për vlerësimin të kërkesës apo argumentim të indicies, të përshkruajë dokumentacionin dhe analizën e të dhënave mbi të cilat është mbështetur për marrjen e vendimit për propozim të përditësimit të “dosjes së të dhënave të disponueshme”, personat përgjegjës dhe hallkat e miratimit të tij.

Menjëherë

7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e aksesit në publikimet e çmimeve për artikujt e plastikës, të cilat publikohen nga Kompania “██████”, çdo 7 ditë, “Loparex Holding BV”, me qëllim që azhurnimi i të dhënave për lëndët e para plastike të klasifikuara në kodet 3902 “polipropilen”, 3901 “polietilen” dhe 3904 “PVC”, të kryhet sipas udhëzimit nr. 6, datë 31.01.2013 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007”.

Menjëherë

8. Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore në përputhje e zbatim të Kodit Doganor nenit 273, pika 2, t’ju kërkojë Degëve Doganore respektive, që për 16 subjektet, sipas tabelën pasqyruar në faqen nr. 133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, vendosjen e një gjobë që shkon nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore, që duhen paguar për mallrat në fjalë.

Menjëherë

9. Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore në përputhje e zbatim të Kodit Doganor nenet 256/4 dhe 275/2, t'ju kërkojë Degëve Doganore respektive për subjektet që janë mbajtur procesverbale e vendosur gjobë, si në tabelën pasqyruar në faqet nr. 134-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, detyrimet doganore që duheshin paguar për mallrat objekt shkelje dhe për çdo shkelje ndëshkimi me gjobë në veçanti.

Menjëherë

10. Drejtoria Juridike në çdo rast të ankimimeve për vendimet e marra nga Autoritetet Doganore Kompetente të evidentojë dokumentacionin shkresor dhe në përfundim të afateve të dorëzojë praktikën në arkiv, si dhe dokumentacioni të renditet në mënyrë kronologjike, duke vënë në aktin e fundit shenjë "A/A" (akti në arkiv), datën e përfundimit të çështjes dhe nënshkrimin e zbatuesit.

Menjëherë

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i kërkojmë përshpejtimin e procedurave për sigurimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të KLSH-së dërguar në Degën e Doganës Tiranë me shkresën nr. 544/8, datë 20.09.2016, Degën e Doganës Kakavijë me shkresën nr. 305/20, datë 07.07.2016, Degën e Doganës Durrës, me shkresën nr. 1111/23, datë 19.05.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për ndjekjen e praktikave që mundësojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna në Degën e Doganës Tiranë, nga KLSH, në vlerën **62,599 mijë lekë** përmes verifikimeve doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe për praktikat doganore që lidhen me rekomandimet e lëna në Anekset nr. 1 dhe 3.

Nga auditimi i brendshëm i DPD, të analizohet përgjegjësia institucionale për zvarritjen e përgjigjeve që do të mundësonin arkëtimin në buxhet të shumave të konstatuara si shmangie të detyrimeve doganore.

Në vijimësi

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për ndjekjen e praktikave që mundësojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna në Degën e Doganës Kakavijë, nga KLSH, në vlerën **37,405,409 lekë** përmes verifikimeve doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe për praktikat doganore që lidhen me rekomandimet e lëna në anekset nr. 26 dhe 27. Nga auditimi i brendshëm i DPD, të analizohet përgjegjësia institucionale për zvarritjen e përgjigjeve që do të mundësonin arkëtimin në buxhet të shumave të konstatuara si shmangie të detyrimeve doganore.

Menjëherë

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa konkrete, për të zgjidhur në Degën e Doganës Kakavijë, problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor **në vlerën**

299,721 mijë lekë, duke angazhuar të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi kërkesat e legjislacionit doganor nëpërmjet një programi të posaçëm, për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që rezultojnë në gjendje debitorë në vlera të mëdha.

Menjëherë

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për subjektet që operojnë në Degën Doganore Kakavijë dhe që kanë kryer transporte që përfshihen në krerët *0102*, *0103*, *0104*, *0105* të kryejë veprime hetimore verifikuese, pranë Autoriteteve Doganore Homologe ku janë lëvruar mallrat, me qëllim kërkimin dhe verifikimin e saktë të të dhënave që lidhen me vlerën e mallit dhe peshën e këtyre mallrave të lëvruara dhe të transaktuara pranë selive të kompanive lëvruesve në cilësinë e eksportuesve të këtyre mallrave.

Menjëherë

5. Drejtoria e Vlerës pranë DPD të pasqyrojë saktë përcaktimet për Krerët Tariforë *4803* dhe *4818* në dosjen e të dhënave të disponueshme për qëllime të vlerësimit doganor sipas karakteristikave dhe shpjegimeve të përputhura me shpjegimet dhe shënimet e Nomenklaturës së Mallrave në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

6. Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa konkrete në përputhje me legjislacionin në fuqi, si me obligimet reciproke të përcaktuara në marrëveshjen e përbashkët të nënshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese apo nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja dhe me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor në Degën e Doganës Durrës.

Menjëherë

7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që të verifikojë dhe të analizojë situatën e deklarimit të tatim fitimit nga subjektet e dyta të cilat operojnë jashtë regjimit të TVSH-së. Gjithashtu të analizohet dhe verifikohet gjendja e Tatimit të Vlerës së Shtuar që deklarojnë subjektet e treta gjatë shitjes së karburantit në territorin shqiptar.

Menjëherë

8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 41 raste në Degët Doganore Tiranë, Kakavijë, Berat, Korçë dhe Shkodër, për vlerën **18,528,639** lekë, nga subjektet sipas aneksit nr. 8.1, 8.2, 8.3 dhe 10.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të

Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015 si dhe anekseve 12.1-12.4, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 545/46, datë 26.09.2016, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e **dëmit në shumën 91,274,257 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1 Vlera prej **88,578,109 lekë** në 76 raste, pasqyruar në Anekset nr. 3,4,5,6 dhe 7 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për veprimeve në kundërshtim me Ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005 për “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore, udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “Të dhëna të disponueshme për shpenzimet e transportit” të Ministrit të Financave, ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar për mallin e akcizës të gjetur në mungesë në Magazinë Fiskale.

Deri më 31.03.2017

2. Vlera prej **1,771,518 lekë** në **6 raste**, sipas aneksit nr. 8 bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit, ku degët doganore nuk kanë vepruar për refuzimin e trajtimit preferencial dhe aplikimin e detyrimeve doganore se bashku me sanksionet.

Kjo ka rezultuar gjatë vërtetimit të certifikatave EUR.1, si për rastet kur nga autoritetet doganore homologe nuk ka ardhur përgjigje brenda 10 muajve nga data e kërkesës për verifikimin e provave të origjinë, dhe për rastet kur Degët Doganore janë njoftuar zyrtarisht për refuzim të trajtimit preferencial.

Deri më 31.03.2017

3. Vlera prej **763,670 lekë** në 37 raste, pasqyruar në Anekset nr. 1 dhe 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për veprimeve në kundërshtim me përcaktimet dhe kërkesat e parashikuara nga VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika 2 dhe UKM nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të KM “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. ku janë përfituar dhe kryer padrejtësisht pagesa më tepër, pa dokumente shoqëruese justifikuese, nga trajtimi financiar i punonjësve të aparatit të DPD të dërguar me shërbim brenda vendit, jashtë qendrës së punës.

Deri më 31.03.2017

4. Vlera prej **160,960 lekë** në 3 raste, pasqyruar në Aneksin nr. 9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku nga AK nuk janë llogaritur e ndalur penalitet për mos realizim të sasisë së zërave të riparimit dhe vlerës së kontratave me objekte “Mirëmbajtja e sistemit të peshimit” dhe “Mirëmbajtja e pajisjeve të kontrollit, skanerët”, në mospërputhje me nenet “Përfaqësimi i palëve” dhe “Sanksionet” të përcaktuara në kontratat e lidhura midis palëve, ku kontaktuesit detyrohen të paguajnë penalitet në masën 2/1000 në ditë për vlerën e pa realizuar të kontratës nga data e situacionit dhe faturës së fundit, si edhe janë kryer pagesa me procedurë “blerje e vogël”, për gjoba të tejkalimit të afatit në kontrollit teknik për 6 targa automjeti, pagesë e pa justifikuar për qëllimin e kryer, sepse gjoba për tejkalim afati i ngarkohet drejtuesit të mjetit.

Deri më 31.03.2017

2. DEGA E DOGANËS RINAS

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Rinas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për periudhën 01.10.2013 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1112/8, datë 31.03.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Dega Doganore Rinas, me urdhrin e brendshëm të Kryetarit të Degës së Doganës Rinas me nr. 1084/1, datë 25.04.2016, është kërkuar që nga çdo sektor të rishikohen rekomandimet e KLSH-së. Nga Dega e Doganës Rinas sipas urdhrin të brendshëm nr. 1486 datë 09.05.2016 është miratuar Plani i Veprimit në lidhje me rekomandimet e KLSH-së sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku janë përcaktuar detyrat dhe afatet sipas sektorëve përkatës, i cili i është dërguar për informim edhe në KLSH, por nuk është respektuar afati 20 ditë.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Dega e Doganës Rinas, me shkresat nr. 2278 datë 26.07.2016 dhe nr. 3243, datë 18.10.2016 ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10 masa, janë zbatuar plotësisht 7 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa.
- b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 8 masa në shumën 18,418,733 lekë, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 8 masa, nga të pranuarat është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 4 masa.
- c. Janë rekomanduar 4 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 4 masa.

Degës së Doganës Rinas *i kërkojmë* përsheptimin e procedurave për sigurimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të KLSH-së të dërguar me shkresën nr. 1112/8, datë 31.03.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të

rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 1112/8, datë 31.03.2016, nga Dega e Doganës Rinas, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e **dëmit në shumën 7,305,648 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **270,501 lekë** nga 7 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 1 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për rivlerësim të detyrimit doganor i pranuar me vlerën e transaksionit të faturës, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore të parashikuara në neni 33- 38 të KD për periudhën viti 2014.

Deri më 31.03.2017

2. Vlera prej **139,785 lekë** nga 5 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 2 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor me keqklasifikim të artikujve jo në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave të parashikuara nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD.

Deri më 31.03.2017

3. Vlera prej **201,325 lekë** nga 2 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 3 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor me diferencë në peshën e deklaruar të artikullit jo në përputhje peshën e artikullit e pasqyruar në fletë-peshën e lëshuar nga dogana, parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 261.1/2 të KD.

Deri më 31.03.2017

4. Vlera prej **18,740 lekë** (Detyrim Doganor prej 4,685 lekë + Gjobë prej 14,055 lekë) nga operatori ekonomik “” me NIPT sipas trajtimit në faqen 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit për llogaritjen dhe vlerësimin detyrimit doganor me përfitimin e origjinës preferenciale të mallit, jo në përputhje me dokumentet shoqëruese dhe kriteret ligjore të protokollit nr. 5 të MSABE.

Deri më 31.03.2017

5. Vlera prej **70,000** nga 2 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 4 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për penalitete kundravajtjet administrative të evidentuara në procesin e vlerësimit të detyrimit doganor, parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD për periudhën viti 2014.

Deri më 31.03.2017

6. Vlera prej **231,288 lekë** nga 2 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 5 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 48-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor për diferencë të rezultuar e penalitet për kundravajtje administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së regjimeve të përpunimit aktiv të mallrave sipas autorizimeve përkatëse parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD për periudhën objekt auditimi.

Deri më 31.03.2017

7. Vlera prej **6,644,510 lekë** nga 2 operator ekonomik, [REDAKTUAR] me NIPT [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me NIPT [REDAKTUAR], pasqyruar në Aneksin nr. 5 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 48-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për mos llogaritje të detyrimit doganor dhe mos aplikim penaliteti për kundërvajtje administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së Regjimit të Lejimit të Përkohshëm të mallrave në përputhje e zbatim të neneve 99, 157-164 dhe nenit 273, pikat 1 e 2 të Kodit Doganor.

Deri më 31.03.2017

3. DEGA E DOGANËS KORÇË

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Korçë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 741/5, datë 16.12.2015, konstatohet se:

Nga Dega e Doganës Korçë është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Dega e Doganës Korçë, ka hartuar *Plan Veprimin*, nr. 3943/1, datë 26.12.2015 dhe me shkresën nr. 66, datë 06.01.2016 ka dërguar në KLSH “*Plan Veprimi*”.

Nga Dega e Doganës Korçë, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 741/21, datë 28.06.2016, por jo brenda afatit ligjor prej 6 muajsh, jo në përputhje me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. 3 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë.
- b. 6 masa shpërblim dëmi, në vlerën 274,322 mijë lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat: janë zbatuar plotësisht 2 masa, është në proces zbatimi 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 3 masa.
- c. 5 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar plotësisht por jo në masën e rekomanduar.
- d. 5 masa administrative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar plotësisht, Autoriteti Vendimmarrës ka dalë me vendime administrative.

Degës së Doganës Korçë *i kërkojmë* përshpejtimin e procedurave për sigurimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 741/5, datë 16.12.2015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 741/5, datë 16.12.2015, nga Dega e Doganës Korçë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **266,022,883 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Dega e Doganës Korçë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **23 raste**, në vlerën **243,706,790 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 741/5, datë 16.12.2015.

Deri më 31.03.2017

2. Dega e Doganës Korçë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **65 raste**, në vlerën **18,936,411 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 741/5, datë 16.12.2015.

Deri më 31.03.2017

3. Dega e Doganës Korçë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **33 raste**, në vlerën **3,379,682 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 6 dhe 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 741/5, datë 16.12.2015.

Deri më 31.03.2017

4. DEGA E DOGANËS KAPSHTICË

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Kapshticë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 794/10, datë 31.12.2015, konstatohet se:

Nga Dega e Doganës Kapshticë, është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Është kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 20/17, datë 04.07.2016, brenda afatit 6 mujor në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. 4 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 4 masa. Nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 2 masa dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht.

b. 4 masa shpërblim dëmi, në vlerën 125,348,712 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht 4 masa, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 1 masë dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa.

c. 8 masa disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar plotësisht 8 masa. (me shkresën nr. 1655 prot., datë 04.07.2016 “Përcjellje për kompetencë”, si dhe shkresën nr. 2467 prot., datë 28.10.2016 “Për fillimin e ecurisë disiplinore”, drejtuar Komisionit Disiplinor pranë D.P.D ka konkluduar mbi vijimin e ecurisë së masave disiplinore të rekomanduara për punonjësit e sipërcituar).

d. 10 masa administrative, të cilat janë pranuar plotësisht 10 masa, nga të cilat 3 masa janë zbatuar plotësisht dhe 7 masa nuk janë zbatuar.

Degës së Doganës Kapshticë i kërkojmë përsheptimin e procedurave për sigurimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 794/10, datë 31.12.2015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nga Dega e Doganës Kapshticë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **75,754,116 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Dega e Doganës Kapshticë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **50,569,165 lekë** nga subjektet sipas anekseve nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 13, 17, 18, 22 dhe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 794/10, datë 31.12.2015.

Deri më 31.03.2017

2. Dega e Doganës Kapshticë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën **24,877,626 lekë** nga subjektet sipas anekseve nr. 24, 25, 26 dhe 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 794/10, datë 31.12.2015.

Deri më 31.03.2017

3. Dega e Doganës Kapshticë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën **307,325 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 30 të Projektraportit të Auditimit

Deri më 31.03.2017

D. MASA ADMINISRATIVE

Dega e Doganës Kapshticë, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të marrë masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, për penalitet në masën 50,000 deri në 200,000 lekë, për agjencitë doganore:

1. “ [REDACTED] ” me nr. [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED] dhe z. [REDACTED]
2. “ [REDACTED] ” me nr. [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED] dhe z. [REDACTED]
3. “ [REDACTED] ” me nr. [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED] dhe z. [REDACTED].;
4. “ ” me nr. [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED]
5. “ [REDACTED] ” me nr. [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED]
6. “ [REDACTED] ” me nr. [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED]
7. “ [REDACTED] ” me numër [REDACTED] me përfaqësues z. [REDACTED]..

Menjëherë

5. DEGA E DOGANËS KAKAVIJË

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Kakavijë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 305/20, datë 07.07.2016, konstatohet se:

Nga Dega e Doganës Kakavijë, është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Dega Doganore Kakavijë, me shkresën nr. 2281/2, datë 15.07.2016, ka miratuar Planin e Veprimit, ku janë përcaktuar detyrat dhe afatet sipas sektorëve përkatës, dhe me shkresën nr. 2281/3, datë 28.07.2016 ka kthyer përgjigje në KLSH.

Nga Dega e Doganës Kakavijë, nuk është kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor për arsye se afati i zbatimit të rekomandimeve nuk është plotësuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. 16 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 16 masa. Nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 10 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 2 masa.
- b. 5 masa shpërblim dëmi, në vlerën 89,612,733 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 5 masa. Nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces 2 masa dhe

pazbatuar 1 masë. Për rikërkim shpërblim dëmi nga auditimet e mëparshme është lënë 1 rekomandim në vlerën 30,930,774 lekë dhe 6,474,665 lekë i cili rezulton në proces zbatimi.

c. 6 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar plotësisht, (me shkresat nr. 3618 prot., nr. 3619 prot. dhe nr. 3620 prot., datë 25.11.2016 “Propozim për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit”, drejtuar Komisionit Disiplinor pranë D.P.D ka konkluduar mbi vijimin e ecurisë së masave disiplinore të rekomanduara për punonjësit e sipërcituar).

d. 3 masa administrative, të cilat janë pranuar të gjitha dhe janë në proces zbatimi.

Degës së Doganës Kakavijë i kërkojmë përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën 305/20, datë 07.07.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Autoriteti Doganor Kakavijë të kërkojë arkëtimin e menjëhershëm të vlerës së garancisë doganore në shumën prej 2,392,000 lekë nga subjekti “**██████████**” me NIPT **██████████**, sipas aneksit nr. 1, trajtuar në faqet 86-105 të Raportit Përfundimtar, bazuar në nenin 204 “Personi që jep garancinë” nenit 205/206/207/208/209/210/211/212/213 dhe 214 të Kodit Doganor nga deklaruesi i mallit ose përfaqësuesi i tij si dhe deklarohet ose garantohet shlyerja e gjithë detyrimeve doganore të mundshme që mund të lindin në rast të ardhjes së një përgjigjeje negative nga Autoriteti Doganor Homologe i Greqisë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë me shkresën nr. 305/20, datë 07.07.2016, nga Dega e Doganës Kakavijë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **88,793,928 lekë**, në mënyrë analitike nga pika 1-3 edhe sipas anekseve nr. 1 deri nr. 24, përfshirë dhe masën organizative nr. 6 (2,392,000 lekë), si më poshtë:

1. Vlera prej **68,049,292 lekë** (detajuar sipas anekseve nr. 2-23), trajtuar në faqet 17-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për veprime jo në përputhje me nenet 34-37 të KD dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” si dhe shpjegimeve dhe përcaktimeve të përcaktuara në kërkesat e Shtojcës (Aneksit) 4 të Protokollit të Origjinës si dhe nenit 22.4 të Udhërrëfyesit “Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale sipas MTL” si dhe Udhëzimit

nr. 5883, datë 16.05.2006 për “Dokumentacionin e detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”.

Deri më 31.03.2017

2. Vlera prej **15,856,636 lekë** (nga 15 subjekte, sipas aneksit nr. 1), trajtuar në faqet 86-105 të Raportit Përfundimtar Auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe ato ligjore, për mos vjeljen e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore gjatë marrjes së vendimeve administrative jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, nga të cilat vlera **6,318,000 lekë** i përket vitit 2014.

Deri më 31.03.2017

3. Vlera prej **2,496, 000 lekë** (nga 18 subjekte, sipas aneksit nr. 24), trajtuar në faqet 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si gjoba doganore për mos paraqitjen e praktikave doganore tranzite në doganën e destinacionit, brenda afatit limit të përcaktuar nga doganat nisëse, veprime të kryera në kundërshtim me nenit 260 të Kodit Doganor, për të cilat duhet të ishte aplikuar gjoba në vlerë 30,000 lekë për çdo 5 orë vonesë.

Deri më 31.03.2017

B.2. RIKËRKIM SHPËRBLIM DËMI NGA AUDITIMET E MËPARSHME

4. Nga Dega e Doganës Kakavijë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë procedurale dhe ligjore shpërblimi i **dëmit në shumën 30,930,774 lekë dhe 6,474,665 lekë** rekomanduar në auditimet e mëparshme dhe detajuar në anekset 26 dhe 27, për mosvjeljen e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore që janë konstatuar gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave, keqklasifikime tariforë etj.

Deri më 31.03.2017

D. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit i rekomandojmë **Degës së Doganës Kakavijë** të aplikojë penaltet në masën nga 50,000 lekë deri në 200,000 lekë, për:

1. Për agjencinë doganore “**██████**” me numër **██████** e cila operon pranë Degës së Doganës Kakavijë për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, 13 raste, në shkëlqe të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.3 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Për agjencinë doganore “**██████**” me numër **██████**, e cila operon pranë Degës së Doganës Kakavijë për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, 6 raste, në shkëlqe të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Menjëherë

6. DEGA E DOGANËS TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 544/8, datë 20.09.2016, konstatohet se:

Dega e Doganës Tiranë, me shkresën nr. 10564, datë 13.10.2016 ka miratuar Planin e Veprimit, por nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda afatit 20 ditë nga marrja dijeni, jo në përputhje me kërkesat e nenit 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Dega e Doganës Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor për arsye se afati i zbatimit të rekomandimeve nuk është plotësuar. Për rekomandimet të cilat kanë afatin e zbatimit të menjëhershëm ose më të shkurtër së afati 6/mujor, Dega e Doganës Tiranë, me shkresën nr. 5077/23, datë 27.10.2016, ka kërkuar shtyrje të afatit kohor për realizimin e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. 12 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 12 masa, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces 7 masa.
- b. 6 masa shpërblim dëmi, në vlerën 383,887,201 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 masa, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces 4 masa.
- c. Nga 12 masa disiplinore të rekomanduara, janë pranuar plotësisht dhe për arsye se masat disiplinore janë të lidhura me zbatimin e rekomandimeve për shpërblim dëmi, janë në proces zbatimi.
- d. 6 masa administrative, të cilat janë pranuar të gjitha dhe Autoriteti Vendimmarrës ka dalë për të gjashtë rastet me vendime administrative.

Degës së Doganës Tiranë *i kërkojmë* përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 544/8, datë 20.09.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 544/8, datë 20.09.2016 , nga Dega e Doganës Tiranë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e efektit financiar në vlerën **346,561,201 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **124,719,100 lekë** nga subjektet sipas anekseve nr. 1-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.03.2017

2. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **13 raste**, në vlerën **8,842,101 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Deri më 31.03.2017

3. Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **17 raste**, në vlerën **209,800,000 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 17, të Raportit Përfundimtar.

Deri më 31.03.2017

4. Vlera prej **3,200,000 lekë** penalitete të llogaritura për **16** subjekte të akcizës, trajtuar në faqet nr. 123-146 të RPA, për shkeljen e afateve të kalibrimin dhe certifikimin të depozitave ku administrohen lëngje, të cilat trajtohen me akcizë si birrë, verë, pije alkoolike dhe raki, për vitin 2015.

Deri më 31.03.2017

7. DEGA E DOGANËS DURRËS

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Durrës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1111/23, datë 19.05.2016, konstatohet se:

Dega e Doganës Durrës, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 17907/40, datë. 26.05.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuar, në përputhje me kërkesat e nenit 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Dega e Doganës Durrës nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 6 mujor, jo në përputhje me kërkesat e nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Dega Doganore Durrës, me shkresën nr. 17907/52, datë 25.10.2016, për arsye objektive (lëvizje e burimeve njerëzore dhe volumit të madh të punës), i është kërkuar KLSH-së shtyrja e afatit për përmbushjen e Rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit deri më datën 31 dhjetor 2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. 16 masa organizative, nga të cilat 9 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 4 masa rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe 3 masa rezultojnë në proces zbatimi.
- b. 12 masa shpërblim dëmi, në vlerën 321,565 mijë lekë, të cilat janë në proces zbatimi.

c. 15 masa disiplinore, të cilat janë pranuar plotësisht dhe për arsye se masat disiplinore janë të lidhura me zbatimin e rekomandimeve për shpërblim dëmi, janë në proces zbatimi.

d. 13 masa administrative, të cilat janë pranuar të gjitha dhe është bërë njoftimi i agjencive përkatëse.

Degës së Doganës Durrës *i kërkojmë* përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1111/23, datë 19.05.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1111/23, datë 19.05.2016, nga Dega e Doganës Durrës, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e efektit financiar në vlerën **321,565 mijë lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera 57,655 mijë lekë, sipas anekseve nr. 16, trajtuar në faqet nr. 23-64 të RPA, për 34 rastet e shqyrtimit jo si duhet të vlerës doganore të mallrave, gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar të mallrave për subjektin “ ” veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave.

Deri më 31.03.2017

2. Vlera 64,528 mijë lekë, sipas anekseve nr. 4-19, trajtuar në faqet nr. 23-64 të RPA, për trajtimin me origjinë preferenciale të artikujve me deklaratë faturë vlera e të cilëve e kalon 6000 euro; keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar të mallrave, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, për rivlerësimin e doganor dhe mos llogaritjen e saktë të detyrimeve, në Sektorin (Sheshin) e Trageteve për vitin, 2015.*

Deri më 31.03.2017

3. Vlera 10,780 mijë lekë, sipas anekseve 19-22, trajtuar në faqet 64-75 RPA, për rastet e shqyrtimit jo si duhet të vlerës doganore të mallrave, gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar të mallrave, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave, nga e cila vlera i përket 2,825 vitit 2014.

Deri më 31.03.2017

4. Vlera 30,313 mijë lekë, sipas anekseve 23-41, trajtuar në faqet 75-97 RPA, për raste të keqklasifikimit tarifor të artikujve; shqyrtim e pa saktë të vlerës doganore të mallrave, mospagesës së taksës së akcizës dhe të ambalazhit plastik, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2, si dhe udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, ligji 61 “Për Akcizat në RSH” në sektorin e kontenierëve, nga e cila vlera prej 14,647 mijë lekë i përket vitit 2014.

Deri më 31.03.2017

5. Vlera 2,548 mijë lekë në 14 raste, trajtuar në faqet e nr. 174-176 të RPA, në lidhje me arkiv-protokollin, rezultuan disa shkresa me shkelje në fushën doganore për të cilat nuk është mbajtur procesverbal; apo raste të procesverbaleve të mbajtura për shkelje në fushën doganore, për të cilat autoriteti doganor kompetent nuk ka nxjerr Vendime Administrativ veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Kodit Doganor. nenet 285.4, 286, 287.1 dhe 289.1, si më poshtë.

-8 raste, në vlerën 645 mijë lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-2 raste, në vlerën 1,468 mijë lekë për subjektin “XXXXXXXXXX”, trajtuar në faqet nr. 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-4 raste, në vlerën 435 mijë lekë nga subjektet për të cilët autoriteti doganor kompetent ka nxjerrë Vendime Administrative, por nuk ka ndjekur rrugët ligjore për rikuperimin e borxhit doganor, trajtuar në faqet nr. 42-44 të RPA.

Deri më 31.03.2017

6. Vlera 2,600 mijë lekë, nga 13 subjekte me statusin e magazinës fiskale prodhues dhe tregtues të produkteve të akcizës, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe trajtimit të bërë në faqet 145-154 të këtij RPA, për mos llogaritje të penalteteve nga DDD në kundërshtim me ligjin nr. 61/2012 datë 05.04.2012 “Për akcizën në RSH” me ndryshime, VKM-në nr. 612, datë 05.09.2012, nenit 85 pika 1/a, nenit 96/1 pika 1, dënohen me gjobë që shkon, deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

Deri më 31.03.2017

7. Vlera 550 mijë lekë, nga 11 subjekte me statusin e magazinës fiskale prodhues dhe tregtues të produkteve të akcizës, sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe trajtimit të bërë në faqet 145-154 të këtij RPA, për mos llogaritje të penalteteve nga DDD, në kundërshtim me ligjin nr. 61/2012 datë 05.04.2012 “Për akcizën në RSH” me ndryshime, neni 54, pika 7, neni 65 germa “b” si dhe në bazë të ligjit nr. 8449, date 27.01.1999, “Kodi doganor i RSH” neni 256, paragrafi 2 si dhe neni 275 paragrafi i parë, subjekti penalizohet me 50,000 lekë për çdo rast.

Deri më 31.03.2017

8. Vlera 42,759 mijë lekë, nga 2 subjekte sipas aneksit nr. 3 trajtuar në faqet nr. 114-138 të RPA, për diferenca rezultuar nga inventarët e kryera, për mos llogaritjen e detyrimeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, për vitin, 2015.

Deri më 31.03.2017

9. Vlera 750 mijë lekë, nga 15 subjekte, trajtuar në faqet nr. 114-138. të RPA, për keq administrim të Regjimit të Përpunimit Aktiv për shkeljen e afateve të mbylljes së autorizimeve, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret e ligjore, për vitin, 2015.

Deri më 31.03.2017

10. Vlera 2,291 mijë lekë detyrime doganore të konstatuara gjatë auditimit të Regjimit të Tranzitit, si rezultat i mos mbylljes në sistem të 18 praktikave doganore T1, për vitin 2015.

Deri më 31.03.2017

11. Vlera 52,202 mijë lekë nga 26 subjekte sipas aneksit nr. 42 trajtuar në faqet 154-174 të PRA, për shkelje të Legjislacionit Doganor sipas ligjit 8449 “Kodi Doganor në RSH”, Ligjit nr 61 “Për Akcizat në RSH” dhe mos llogaritjen e detyrimeve, si dhe për mos arkëtimin e tyre, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e duhura ligjore, për vitin, 2015.

Deri më 31.03.2017

12. Vlera 54,859 mijë lekë nga 1260 raste sipas anekseve nr. 44-72, trajtuar në faqet nr. 97-114 të RPA, për rivlerësimin e doganor dhe mos llogaritjen e detyrimeve, si dhe për mos arkëtimin e tyre, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e legjislacionit doganor.

Deri më 31.03.2017

C. MASA DISIPLINORE

Nga KLSH, mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Doganës Durrës, që në vlerësim të shkeljeve, të mëposhtme sipas pikës 1 gërma ”a” “b” “c” dhe “ç” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 gërma “ç”, “largim nga shërbimi civil” për nëpunësin civil.

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë ish Kryetar,
2. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjës turni;

3. Për z. [REDACTED] me detyrë ish përgjegjës turni, aktualisht doganier i Anti kontrabandës Detare;
 4. Për z. [REDACTED] me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
 5. Për z. [REDACTED] me detyrë doganier klasifikim/vlerë,
 - 6- Për z. [REDACTED] me detyrë përgjegjës turni pranë sektorit Porto Romano
 - 7- Për z. [REDACTED] me detyrë përgjegjës turni pranë sektorit Porto Romano
 - 8- Për z. [REDACTED] me detyrë doganier vlerësimi pranë sektorit Porto Romano
 - 9- Për z. [REDACTED] me detyrë doganier vlerësimi pranë sektorit Porto Romano
- b. Neni 58 gërma “a-b”, nga “vërejtje” deri në “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për nëpunësit civil, si më poshtë:**
10. Për z. [REDACTED] me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
 11. Për z. [REDACTED] me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
 12. Për z. [REDACTED] me detyrë doganier klasifikim/vlerë;
 13. Për z. [REDACTED] me detyrë përgjegjës i sektorit të anijeve,
 14. Për z. [REDACTED] me detyrë jurist
 15. Për z. [REDACTED] me detyrë doganier klasifikim/vlerë

Menjëherë

8. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 304/17, datë 18.07.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DPT, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 8110/50, datë 03.08.2016, protokolluar në KLSH me nr. 304/18, datë 04.08.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DPT Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor mbasi nuk është plotësuar afati 6/mujor i dhënies së rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10 masa , janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces 8 masa.
- b. Për shpërbllim dëmi është lënë 1 rekomandim në shumën 1,080,000 lekë, i cili është në proces zbatimi.
- c. Për masa disiplinore i është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve që në vlerësim të shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të bëjë analizimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi. Nga DPT nuk është vlerësuar për fillim procedure disiplinore për ndonjë punonjës.

Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i kërkojmë përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 304/17, datë 18.07.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Nisur nga fakti se nuk është vepruar lidhur me masën e shpërblimit të dëmit nga subjekti “██████████”, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,080,000 lekë** nga subjekti, “██████████”, për përfitim të padrejtë të vlerës së shërbimit të mirëmbajtjes për tre muajt Janar-Mars 2016, pa u përmbushur kontrata për të cilën është lidhur kjo Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit (MNSH), mirëmbajtje e sistemit “M-Taxation”. Operatori ekonomik, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale të mëparshme, ndryshe nga çfarë është deklaruar nga komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj kontrate. Veprimet sa më sipër janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9634, datë “Për prokurimin publik”, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, udhëzimit nr. 2 datë 02.09.2013 të AKSHI-t, “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në administratën publike”.

Menjëherë

D. TË TJERA

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, është konstatuar qëndrimi me dy standarde në lidhje me mbajtjen e tatimit në burim (tatim dividendi dhe tatim qiraje). Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka zbatuar plotësisht rekomandimet në lidhje me dividendin dhe qiranë, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës ka zbatuar vetëm rekomandimin mbi tatimin e qerasë. Drejtoritë e tjera nuk i kanë pranuar rekomandimet tona.

Sjellim në vëmendje se nga disa drejtori rajonale tatimore është konstatuar problematika e miratimit të shpërndarjes së dividendit pas miratimit të rezultatit financiar, bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, nenit 33/1 “*Depozitimi i vendimit pas miratimit të rezultatit vjetor dhe destinacionit të fitimit*” ku cilësohet në pikën 1, “*Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi*”. Në pikën 3 kërkohet që “*Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit*”.

Dividendi është shpërndarja e fitimit pas tatimit për pronarët pas miratimit të rezultatit financiar. Pra dividendi është i lidhur me fitimin dhe po ti referohemi nenit 19 të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” “Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim. Në këtë kontekst dividendi nuk mund të shkëputet nga momenti i miratimit të rezultatit financiar.

Nga ana tjetër sjellim në vëmendje se dividendi rrjedh nga fitimi i tatueshëm dhe trajtimi i tij vetëm fiskalisht, shkëputur nga konteksti kontabël ndërkohë që në vetë kërkesën ligjore orientohet nga kërkesat e ligjit për “Për kontabilitetin”, ka lënë hapësira për interpretime subjektive nga ana e administratës tatimore.

Shpjegojmë se po ti referohemi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit respektivisht SKK nr. 1 – Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, në pjesën e trajtimit të ngjarjeve pas përfundimit të periudhës raportuese cilësojmë rastin:

Deklarimi i dividendëve pas përfundimit të periudhës raportuese.

Nëse një njësi ekonomike u deklaron dividendët mbajtësve të instrumenteve të kapitalit neto të saj, pas përfundimit të periudhës raportuese, njësia ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si një detyrim në fund të periudhës raportuese. Shuma e dividendit mund të paraqitet si një komponent i ndarë nga fitimet e pashpërndara në fund të periudhës raportuese.

Në këto kushte rirekomandojmë që nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pas analizës së rasteve të konstatuara nga KLSH në drejtoritë rajonale tatimore dhe në zbërthim të trajtimit kontabël të dividendit të hartojë një udhëzues teknik, orientues për të gjithë punonjësit e administratës tatimore por edhe për të sensibilizuar taksapaguesit për të ardhmen.

Menjëherë

9. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE DURRËS

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 715/16, datë 28.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRT Durrës, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 14554/148, datë. 08.01.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRT Durrës, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 4 masa organizative, nga të cilat, 4 janë zbatuar plotësisht 4 masa.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 11 rekomandime në shumën 282,123,777 mijë lekë, ku janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime.
- c. Janë rekomanduar 21 masa disiplinore, të cilat janë pranuar dhe realizuar nga DRT Durrës.

Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës *i kërkojmë* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 715/16, datë 28.12.2015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë me shkresën nr. 715/16, datë 28.12.2015, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **në vlerën 146,148,711 lekë**, si më poshtë:

1. Për 34 raste, në **shumën 28,060,114 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për shkelje të procedurave si dhe fshehje dhe shmangie nga pagimi i detyrimeve, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e neneve 126 dhe 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe neneve 33 dhe 33.1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar (*Trajtuar në faqen 34-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

2. Për 23 raste (subjekte), të mos vendosjen e penalteteve në **shumën 50,617,552 lekë**, sipas aneksit nr. 9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (*Trajtuar në faqen 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

3. Për 23 raste (subjekte), të mos llogaritjes së detyrimeve në **shumën 35,226,632 lekë**, sipas aneksit nr. 9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar (*Trajtuar në faqen 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

4. Për 23 raste (subjekte), të mos llogaritjes së detyrimeve në **shumën 32,244,413 lekë**, sipas aneksit nr. 9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar (*Trajtuar në faqen 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

10. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE KUKËS

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 830/13, datë 31.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRT Kukës, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijeni, nuk është hartuar Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRT Kukës, *nuk* ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor megjithëse është plotësuar afati 6/mujor i dhënies së rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 7 masa, nga të pranuarat është zbatuar plotësisht 1 masë, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 3 masa.
- b. Për shpërblim dëmi janë lënë 4 rekomandime në shumën 68, 556 mijë lekë, nga të cilat është zbatuar plotësisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 3 masa.
- c. Janë rekomanduar 5 masa disiplinore, të cilat janë pranuar dhe nga DRT Kukës dhe nga Komisioni i Disiplinës së Tatimeve janë shqyrtuar, janë dhënë masat disiplinore për 2 punonjës dhe është ndërprerë ecuria disiplinore për 3 punonjës.

Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës *i kërkohet* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 830/13, datë 31.12.2015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë me shkresën nr. 830/13, datë 31.12.2015, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të

evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet e prore dhe paralele, Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës i është rekomanduar, të marrë në shqyrtim, të kryej evidentimin dhe kontabilizimin, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **68,556, 232 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Të merren masa për shlyerjen e detyrimeve nga 61 subjekte për vitin 2013 dhe 83 subjekte për vitin 2014, për 271 raste të mos vendosjes së penalteteve **në shumën 2,710,000 lekë**, sipas aneksit nr. 3.2 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e DPMA, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.20068, neni 126 "Mosdhënia e informacionit". *(Trajtuar në faqet 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Menjëherë

2. Të merren masa për rikontrollin, evidentimin dhe përpilimin e njoftim vlerësimeve të detyrimeve të 17 subjekteve, sipas tematikës të trajtuar në këtë raport auditimi, sipas aneksit nr. 4.2, për mosvendosjen e penalteteve **në shumën 62,546,232 lekë**, nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit, shkelje në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" dhe Manualin e Kontrollit. *(Trajtuar në faqet 47-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Menjëherë

3. Të merren masa të menjëhershme për rikontrollin, evidentimin dhe përpilimin e njoftim vlerësimeve të detyrimeve për 50 subjekte, sipas aneksit nr. 4.3, për mosvendosjen e penalteteve **në shumën 3,300,000 lekë**, nga inspektorët e kontrollit në terren, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" dhe Manualin e Kontrollit. *(Trajtuar në faqet 79-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Menjëherë

11. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TATIMPAGUESIT E MËDHENJ

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 306/15, datë 06.07.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", DRTTM Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 3139/33, datë 27.07.2016, protokolluar në KLSH me nr. 306/16, datë 01.08.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRTTM Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor mbasi nuk është plotësuar afati 6/mujor i dhënies së rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 3 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 3 masa dhe janë zbatuar plotësisht 3 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime në shumën 713,122 mijë lekë, ku janë analizuar rekomandimet sipas pikave përkatëse, sipas shumave dhe subjekteve për shpërblim dëmi për të proceduar me aktet përkatëse nga organi vendimmarrës. Janë zbatuar plotësisht 2 rekomandime në shumën 11 305 mijë lekë, është në proces zbatimi 1 rekomandim në shumën 552 409 mijë lekë dhe nuk janë pranuar 3 rekomandime në shumën 149 408 mijë lekë.

c. Janë rekomanduar 17 masa disiplinore, të cilat janë pranuar dhe nga DRTTM Tiranë i është propozuar Komisionit të Disiplinës së Tatimeve për 22 masa disiplinore (nga të cilat për 8 punonjës të pa rekomanduar nga KLSH) dhe nuk janë propozuar masa për 3 punonjës me argumentimin se 1 punonjës është larguar nga sistemi tatimor dhe për 2 punonjës propozimi për masë disiplinore është i lidhur me masat për shpërblim dëmi.

Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj *i kërkojmë* përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 306/15, datë 06.07.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, përsa kohë që ky institucion është brenda afatit 6-mujor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH-së mbi statusin e rekomandimeve të lëna, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë me shkresën nr. 306/15, datë 06.07.2016, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet e prore dhe paralele, i është rekomanduar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesve të Mëdhenj, të marrë në shqyrtim, të kryej evidentimin dhe kontabilizimin, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **701,817,201** lekë, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për 13 raste (subjekte) të merren masa të menjëhershme ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, për detyrimet dhe penalitetet përkatëse të evidentuara nga shqyrtimi i raportit të kontrollit tatimor për periudhat e vitit 2014-2015. Në përfundim të rekomandohet lëshimi i njoftim vlerësimit

përkatës për vjeljen e detyrimeve të lindura në shumën **552,408,541 lekë**, ku është vepruar në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar. (Trajtuar në faqen 50-106 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 4.1 bashkëngjitur këtij vendimi).

Deri më 31.03.2017

2. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për të vlerësuar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, rezultuan se nuk ka penalizuar subjektet, për mos likuidim të tatimit mbi të ardhurat në burim, për çdo muaj në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës së këstit të qirasë, në shkelje të nenit 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar për 16 raste, në vlerën **17,716,498 lekë** (Trajtuar në faqen 39-40 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 3.3.2 bashkëngjitur këtij vendimi).

Deri më 31.03.2017

3. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për të vlerësuar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim, rezultuan se nuk ka penalizuar subjektet, që kanë sjellë me vonesë vendimin e organit përgjegjës dhe paguar me vonesë tatimin mbi dividentin, në shkelje të nenit 33/1, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe Neni 117 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” për 27 raste, në vlerën **128,692,173 lekë** (Trajtuar në faqen 40-42 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 3.3.3 bashkëngjitur këtij vendimi).

Deri më 31.03.2017

4. Për 60 subjekte të mosvendosjes së penaliteteve në vlerën **3,000,000 lekë**, sipas aneksit nr. 3.2.1 dhe 3.2.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 126 “Mosdhënia e informacionit”

Deri më 31.03.2017

12. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 546/21, datë 28.09.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRT Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani, me shkresën nr. 33392/44, datë 27.10.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuara.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRT Tiranë, *nuk* ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor mbasi nuk është plotësuar afati 6/mujor i dhënies së rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 5 masa, nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 8 rekomandime në shumën 464 474 mijë lekë, ku janë analizuar rekomandimet sipas pikave përkatëse, sipas shumave dhe subjekteve për shpërblim dëmi për të proceduar me aktet përkatëse nga organi vendimmarrës. Janë në proces zbatimi 5 rekomandime në shumën 172 080 mijë lekë dhe nuk janë pranuar 3 rekomandime në shumën 292 395 mijë lekë.

c. Janë rekomanduar 21 masa disiplinore, të cilat janë pranuar dhe nga DRT Tiranë i është propozuar Komisionit të Disiplinës së Tatimeve për masa disiplinore.

Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë *i kërkojmë* përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 546/21, datë 28.09.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjell me shkresën nr. 546/21, datë 28.09.2016, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet eprore dhe paralele, Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë i është rekomanduar, të marrë në shqyrtim, të kryej evidentimin dhe kontabilizimin, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **vlerën 464,474,184 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për 36 raste (*subjekte*) të merren masa të menjëhershme ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, për detyrimet dhe penalitetet përkatëse të evidentuara nga shqyrtimi i raportit të kontrollit tatimor për periudhën 2014-2015. Në përfundim të nxirret njoftim vlerësimi përkatës për vjeljen e detyrimeve të lindura në shumën **109,145,699 lekë**, ku është vepruar në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar. (*Trajtuar në faqet 41-125 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 3.1 bashkëngjitur*).

Deri më 31.03.2017

2. Për 312 subjekte, në vlerën 16,810,266 lekë, për penalitete të pa vendosur subjekteve tatimpagues të cilët kanë marrë objekte me qira dhe nuk e kanë paguar tatimin në burim brenda afatit ligjor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33/1/a, nenit 35/b, të ligjit nr.

8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar Neni 117, kjo për sa kohë që nuk dokumentohet momenti i pagesës së qerasë në dosjet e inspektorëve. *(Trajtuar në faqet 17-41 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 2.2.1 bashkëngjitur).*

Deri më 31.03.2017

3. Për 64 subjekte, në vlerën 98,084,703 lekë, për penaltet të pa vendosur subjekteve të cilët kanë vendosur të shpërndajnë dividend pas miratimit të rezultatit financiar në periudhën raportuese të vitit 2014 (për herë të dytë), në kundërshtim me kërkesat e nenit 33/1, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 117. *(Trajtuar në faqet 17-41 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 2.2.2 bashkëngjitur).*

Deri më 31.03.2017

4. Për 3 subjekte, në vlerën 20,950,000 lekë, për mos përllogaritje të tatimit mbi dividendin e shpërndarë në formë paradhënie pa u mbyllur viti financiar 2014, në kundërshtim me kërkesat e nenit 9, pika 2, nenit 33/1, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 117. *(Trajtuar në faqet 17-41 të RPA, si dhe në Aneksin nr. 2.2.3 bashkëngjitur).*

Deri më 31.03.2017

5. Për 12 raste (subjekte) në vlerën 9,859,797 lekë, për mos vendosjen e penalteteve, nga mosrakimi i të dhënave me NJMLF-në sipas nenin 50 pika 2 të Ligjit nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, kanë rezultuar se ka detyrime të papaguara, kamatëvonesa dhe gjoba, për tatimin mbi lojërat e fatit. *(Trajtuar në faqet 17-41 të RPA).*

Deri më 31.03.2017

6. Për 3550 raste të mosvendosjes së penalteteve në vlerën 177,500,000 lekë, sipas aneksit nr. 2.1.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, neni 126 “Mosdhënia e informacionit”. *(Trajtuar në faqet 17-41 të RPA).*

Deri më 31.03.2017

7. Për 11 raste të mos vendosjes së penalteteve në vlerën 28,543,719 lekë, sipas aneksit nr. 2.1.2 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 68 pika 4. *(Trajtuar në faqen 17-41 të RPA).*

Deri më 31.03.2017

8. Për mosvendosjen e penalteteve në vlerën 3,580,000 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, neni 122 pika 1, germa a, b. *(Trajtuar në faqen 42-125 të RPA).*

13. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE FIER

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1110/23, datë 03.05.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", DRT Fier, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën 24424/126 datë 11.07.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuar, jashtë afatit prej 20 ditësh nga marrja dijani

- Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", DRT Fier, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor mbasi nuk është plotësuar afati 6/mujor i dhënies së rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **6 masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 6 masa, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 4 masa dhe janë në proces zbatimi 2 masa.

b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë 8 rekomandime në shumën **107,380,472** lekë, ku janë pranuar 8 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 5 rekomandime në shumën 76,874,587lekë .

c. Janë rekomanduar **20 masa disiplinore**, të cilat janë pranuar dhe nga DRT Fier i është propozuar Komisionit të Disiplinës së Tatimeve për masa disiplinore.

Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier i *kërkojmë* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1110/23, datë 03.05.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë me shkresën nr. 1110/23, datë 03.05.2016, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet eprore dhe paralele, Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier i është rekomanduar, të marrë në shqyrtim, të kryej evidentimin dhe kontabilizimin, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **76,874,587 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për 25 raste (subjekte), të mos vendosjes së penalteteve në shumën **72,394,587 lekë**, sipas aneksit nr. 4.3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (Trajtuar në faqet 79-145 të RPA si dhe aneksi nr. 4.3).

Deri më 31.03.2017

2. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në zbatim të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, për mos deklarimin e punonjësve sipas nenit 119 germa”a”, të merren masa të menjëhershme për evadimin e shkresës protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier me nr. 1822 prot, datë 12.02.2015, në Drejtorinë e Vlerësimit të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit për verifikim dhe vlerësim tatimor si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në shumën **1,000,000 lekë** trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, “Marrëdhëniet me ISSH dhe ISHP” (Trajtuar në faqet 151-159 të RPA).

Deri më 31.03.2017

3. Për 20 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 19 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për shumën **2,900,000 lekë**, sipas Tabelës nr. 4.1 dhe 4.2, për mos aplikim të penalteteve në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar Neni 122.1.b , neni 122 pika 2 germa (i) (Trajtuar në faqet 75-131 të RPA).

Deri më 31.03.2017

4. Për 26 subjekte të mosvendosjes së penalteteve në vlerën **580,000 lekë** , sipas anekseve nr. 3.2.1 dhe nr. 3.2.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 126 "Mosdhënia e informacionit" (Trajtuar në faqet 39-75 të RPA).

Deri më 31.03.2017

III. TË TJERA

1. Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “k”, KLSH për mos zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara do tu drejtohet:

-Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar edhe ndihmën e tij për të sensibilizuar institucionet për rëndësinë e rekomandimeve në rritjen e përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike; si edhe

- Kryeministrit të Shqipërisë, për miratimin e një vendimi apo urdhri në lidhje me dhënien e një vlere detyruese, zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

2. Rekomandimet për zbatimin e rekomandimeve të rezultuara të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “Mbi verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2016”, do të përcillen në subjekte në fillim të muajit janar 2017.

3. Ky auditim është vlerësuar i dobët nga Kryetari i KLSH-së. Nisur nga sa më sipër për të vlerësuar punën e audituesve dhe në mënyrë që të saktësohet shkalla e zbatimit të rekomandimeve, subjektet e përcaktuara sipas programit të auditimit do të riauditohen nga KLSH-ja, në përputhje dhe në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.*”

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R